



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina



Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, shkronja **d** të Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 28/15, qershor 2008), nenit 11, paragrafët 1, 2 dhe 4 të Ligjit nr. 04/L-144, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 35/17, dhjetor 2012), nenit 33.2, shkronja **a**, dhe të nenit 34.1, shkronja **d**, të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110-391, dt. 25.02.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më **31.10.2018**, merr këtë

V E N D I M

- I. **MIRATOHET** propozimi i Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të pronarëve Nexhat (Shaban) Dumnica dhe Liman (Beqir) Jashari.
- II. Prona e paluajtshme komunale që do të jepet në këmbim, ka këto karakteristika: pjesë e parcelës kadastrale nr. 7196-3, , Zona Kadastrale (ZK) Prishtinë, certifikata e pronësisë nr. P71914059-07196-3, e evidentuar si pronë shoqërore, kurse prona e paluajtshme që merret nga ky këmbim është pjesa e parcelës kadastrale nr. 7196-7, ZK Prishtinë, certifikata e pronësisë nr. P-71914059-07196-7, e destinuar për interes publik “rrugë” sipas Planit rregullues “Arbëria 3” Prishtinë, në pronësi të Nexhat (Shaban) Dumnicës dhe Liman (Beqir) Jasharit.
- III. Këmbimi i pronave të paluajtshme është bërë, pasi që nuk ekzistojnë parcela t[] tjera komunale të përshtatshme për realizimin e Planit Rregullues “ Arbëria 3” në Prishtinë. Kjo i shërben shfrytëzimit për qëllime të interes publik të Komunës dhe kapitali për financimin e këmbimit është siguruar.
- IV. Para shpalljes publike të vendimit, do të bëhet vlerësimi i kualifikuar i vlerës së tregut të pronës së paluajtshme komunale dhe vlerësimi i pronës private.
- V. Mënyra dhe kushtet e këmbimit të pronës së paluajtshme do të përcaktohen me kontratë, e cila lidhet dhe nënshkruhet në mes të Kryetarit të Komunës dhe pronarëve të parcelës që do të këmbëhet.
- VI. Pronat e paluajtshme komunale që do të këmbëhen, të përshkruara në pikën II të këtij vendimi, duhet të evidentohen në librat kadastralë të Komunës.
- VII. Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen: Kryetari i Komunës, Drejtorja e Pronës dhe Drejtorja e Kadastrit e Komunës së Prishtinës.
- VIII. Pjesë përbërëse të këtij vendimi janë shkresat e lëndës.



IX. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
14-463/01-0263669/18, më 01.11.2018

KRYESUESI I KUVENDIT
Agim Kuleta



The image shows a handwritten signature in blue ink that overlaps a circular official stamp. The stamp contains the text 'KOMUNA E PRISHTINËS' at the top, 'KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS' around the inner edge, and 'PRISHTINA LIKA KOSOVA' at the bottom. In the center of the stamp is a small emblem featuring a shield with a sun and a mountain range.